



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 5711 Prot.

Roskovec, më 27.10 2020

VENDIM

NR 83. DATË 26.10.2020

**“PËR DHËNIEN NË PËRDORIM ME KUNDËRSHPËRBLIM TË PASURISË NË
PRONËSI TË BASHKISË ROSKOVEC”**

Në mbështetje të nenit 9 pika 1.2 shkronja “a” dhe shkronja “c”, si dhe nenit 54 shkronja “e/1” të ligjit nr.139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar; të neneve 659 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë; Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

1. Dhënie në përdorim me kundërsHPërblim të pasurisë në pronësi të bashkisë Roskovec konkretisht, ambienti me sipërfaqe 60 (gjashtëdhjetë) m² të ndodhur në katin e tretë (teknikisht kati i dytë) të godinës së Bashkisë Roskovec (sipas planvendosjes bashkëngjitur), për tu përdorur për shërbime bar-kafe.
2. Pasuria do të jepet në përdorim për një afat 1 vjekar me të drejtë ripërsëritje.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria Juridike dhe Burimeve Njerëzore për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

